



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DHE EKONOMISË



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 11319 prot.,  
Tiranë, më 13.6.2019

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 2442 prot.,  
Tiranë, më 13.6.2019

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

#### NDËRMJET:

#### MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

*Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE)* i përfaqësuar nga Ministri Znj. Anila DENAJ

dhe

*Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA)* i përfaqësuar nga Kryetari Z. Gentian SALA,

*Të angazhuar për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit,*

*Me dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin në drejtime konkrete*

*Për të siguruar respektimin e detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit,*

Palët bien dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë Marrëveshja).

## **Neni 1**

### **Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në ligjin nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar si dhe në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj marrëveshje bashkëpunimi është përcaktimi i fushave dhe i formave të bashkëpunimit për garantimin e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave audio dhe audiovizive, në rastin e praktikave të padrejta tregtare, në mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorëve.

## **Neni 3**

### **Fusha e bashkëpunimit**

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në sferën e mbrojtjes së konsumatorëve në fushën e mediave elektronike, bashkëpunimi i cili do të fokusohet në sa më poshtë:
  - Angazhimin reciprok për hartimin e akteve nënligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët.
  - Shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues.
  - Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë zbatimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit.
  - Shkëmbimin e informacionit, vlerësimeve dhe rekomandimeve për çështjet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve.
  - Shkëmbimin e informacionit me qëllim që AMA në veprimtaritë e saj mbikëqyrëse dhe rregulluese të subjekteve të licencuar prej saj, të garantojë mbrojtjen e konsumatorëve, në praktikën tregtare, nga praktikën e padrejta tregtare ku përfshihen si praktikën çorientuese dhe ato agresive.
  - Bashkëpunimin për procedimet administrative të iniciuara nga palët e kësaj marrëveshje ose me kërkesë të subjekteve të interesuar, ndaj Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audio dhe/ose Audioviziv (OSHMA) për çështjet e komunikimeve me natyrë tregtare, praktikave të padrejta të OSHMA dhe ofrimit të shërbimeve të tyre me çmime abuzive.



- Organizimin e takimeve të përbashkëta me pjesëmarrjen dhe të palëve të interesuara për mbrojtjen e Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në tregun e mediave audio dhe audiovizive.
  - Publikimi dhe/ose shkëmbimi zyrtarisht i të dhënave dhe informacioneve në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet.
2. Struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bashkëveprim me strukturat zbatuese të legjislacionit për mbrojtjen e konsumatorëve informon AMA, për aktivitetet vjetore të zhvilluara në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.
  3. AMA, nga monitorimi i vazhdueshëm që kryen ndaj OSHMA në mbrojtje të interesave ekonomike të konsumatorëve, kur konstaton shkelje të praktikave të padrejta tregtare, duhet të informojë me shkrim personin përgjegjës të kësaj akt marrëveshje.
  4. Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera për të cilat mund të bihet dakord në të ardhmen.
  5. Secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas formave që përcaktohen nga kjo marrëveshje.

#### **Neni 4**

##### **Koordinimi midis palëve**

1. Palët në zbatim të kësaj marrëveshje do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë vazhdimisht takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit.
4. Palët do të njoftojnë menjëherë në rast se ndryshohet personi i kontaktit.
5. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshje, personat e kontaktit do të jenë:
  - a. Për MFE: Majlinda Hafizi – [majlinda.hafizi@financa.gov.al](mailto:majlinda.hafizi@financa.gov.al);
  - b. Për AMA: Arben Muka – [arben.muka@ama.gov.al](mailto:arben.muka@ama.gov.al);

#### **Neni 5**

##### **Përdorimi i informacionit dhe konfidencialiteti**

1. Secila nga palët e kësaj marrëveshje do t'a përdorë informacionin e marrë vetëm për qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.

2. Veprimet nga palët nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Çdo palë e kësaj marrëveshjeje duhet të ruajë informacionin që merr nga pala tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.
4. Palët nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë palë të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të palës që jep informacionin.

## **Neni 6**

### **Takime të përbashkëta**

1. Çdo 6 muaj, titullarët e të dy institucioneve do të zhvillojnë takime për të diskutuar ecurinë e zbatimit të kësaj marrëveshjeje, me qëllim që të ndërtohet një sferë sa më e sigurt dhe efikase, duke përcaktuar drejtimet për të garantuar mbrojtjen e konsumatorëve.
2. Me iniciativën e secilës palë, për probleme të caktuara, takimet mund të bëhen në çdo kohë edhe me nivelet hierarkike të ndryshme përveç titullarëve.

## **Neni 7**

### **Përmirësimet dhe ndryshime**

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje bashkëpunimi.
2. Çdo shtesë dhe ndryshim do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e palëve të kësaj marrëveshjeje, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

## **Neni 8**

### **Afati i Marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.
3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, për sa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

## **Neni 9**

### **Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Palët marrin përsipër respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga



kjo marrëveshje.

2. Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Në rast ndryshimi të kushteve që kanë diktuar nënshkrimin e saj, palët do të paraqesin dhe miratojnë ndryshimet përkatëse të kësaj marrëveshjeje.
3. Marrëveshja përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe 2 (dy) të tjera pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Palët lexojnë, kuptojnë, pranojnë dhe nënshkruajnë këtë marrëveshje, duke pranuar kështu kushtet saj, në dhe për interes të qëllimeve që përfaqësojnë.

**PËR**

**MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**MINISTRI**  
  
**ANILA DENAJ**  


**PËR**

**AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**KRYETARI**  
  
**GENTIAN SALA**  
